



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 1



Atentat i dështuar në Elbasan/ Tentoi të vriste 50-vjeçarin në një lokal, por iu bllokua arma! Arrestohet autori (VIDEO)
- 2



Kriza politike, ish-ambasadori Çejku: Kurti ka në dorë se si Kosova do të shihet nga miqtë dhe kundërshtarët e saj në këtë moment delikat
- 3



Krimi shtetëror i 21 Janarit, Meta dëshmon në SPAK: Ndërkombëtarët ishin në dijeni të skenarit të dhunshëm të Ramës
- 4



Kuvendi miraton me 74 vota pro Urdhrit e ri të Mjekëve! Jo më shumë se 50 orë pune në muaj të privatit! Gjopa deri në 1 min lekë, pezullim deri në heqje licence për kë abuzon
- 5



Falsifikonin dokumentet që mjetet me targa të huaja të mos paguanin detyrimet doganore, në pranga 2 policë në Kapshticë

Kronikë

Dhunoi kunatën, nipi e kërcënon me armë! Arrestohet xhaxhai, në kërkim 19-vjeçari, 3 nën hetim

Një 34-vjeçar ka dhunuar kunatën e tij dhe në përpjekje për ta trembur, nipi 19-vjeçar shtiu në ajër me armë. 40-vjeçarja dhe një anëtare tjetër e familjes, 25 vjeçe, kanë dhunuar njëra-tjetrën, kurse një tjetër ka tentuar të fshehë provat.



Policia e Dibrës

[Sh] Redaksia 15 Gusht, 11:22 | Përditësimi: 15 Gusht, 11:26

Share Post WhatsApp

A A

Një episod dhune në një familje në Majtarë të Dibrës ka shkuar deri në kërcënimin me armë. Një 34-vjeçar ka dhunuar kunatën e tij dhe në përpjekje për ta trembur, nipi 19-vjeçar shtiu në ajër me armë.

34-vjeçari u vu në pranga, kurse i riu është shpallur në kërkim. 3 të tjerë, përfshirë kunatën janë vënë nën hetim. 40-vjeçarja dhe një anëtare tjetër e familjes, 25 vjeçe, kanë dhunuar njëra-tjetrën, kurse një tjetër ka tentuar të fshehë provat.

Gjithashtu nuk është gjendur as arma e përdorur nga 19-vjeçari.

[Sh]

LEXO EDHE:
Qatip Doda, agronomi që u bë fermer: Si ‘e zbulova’ mjedrën, frutin ftimprurës me kërkesë të lartë në treg! Shitet deri në 800 lek/kg

Njoftimi:

Dhunoi kunatën e tij dhe, gjatë konfliktit, djali i saj qëlloi në ajër me [armë zjarri](#), me qëllim kanosjen e xhaxhait të tij, falë ndërhyrjes në kohë të Policisë, parandalohet përshkallëzimi i mëtejshëm i konfliktit.

Ndalohet 34-vjeçari që dhunoi kunatën, shpallet në kërkim 19-vjeçari që qëlloi me armë zjarri në ajër, si dhe procedohen në gjendje të lirë 3 të tjerë.

Menjëherë pas njoftimit për një konflikt në një familje në fshatin Majtarë, shërbimet e Komisarariatit të Policisë [Dibër](#) organizuan punën dhe shkuan në vendngjarje, për të sqaruar rrethanat dhe përfshirjen në konflikt.

Si rezultat i ndërhyrjes në kohë dhe veprimeve policore, u parandalua përshkallëzimi i mëtejshëm i konfliktit dhe u vu në pranga shtetasi D. E., 34 vjeç, pasi dyshohet se ka dhunuar kunatën e tij, shtetasen F. E., 40 vjeçe.

Ndërkohë, u shpall në kërkim djali i 40-vjeçares, shtetasi F. E., 19 vjeç, i cili dyshohet se ka qëlluar në ajër me armë zjarri, me qëllim kanosjen e shtetasit D. E., xhaxhait të tij. Vijon puna për kapjen e tij dhe kontrollat për gjetjen dhe sekuestrimin e armës së zjarrit të përdorur gjatë konfliktit.

Gjithashtu, filloi procedimi penal në gjendje të lirë për shtetaset F. E., 40 vjeçe, dhe A. E., 25 vjeçe, pasi kanë dhunuar njëra-tjetrën, si dhe për shtetasin E. E., 38 vjeç, pasi dyshohet se ka tentuar të fshehë provat në vendngjarje.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për veprime të mëtejshme.

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë.

P.J/Shqiptarja.com

TAG: dhune fizike arme zjarri Diber

Sa e vlerësoni këtë artikull? ★ ★ ★ ★ ★

★ LAJMET MË TË VLERËSUARA >

Komente

Komento



Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016


SH

Sondazhi i ditës:
Cili është shkaku i konflikteve në Shqipëri?

15 Gusht, 13:45

Politika Shoqëria Social media

Lajme të tjera



Me pistoletë në makinë, pranga 2 të rinjve në Fier! Kërcënoi me armë, arrestohet një tjetër në Mallakastër (VIDEO)

15 Gusht, 13:29



11 vatra zjarri në vend/ 2 avionë ‘Air Tractor’ në Lurë, sigurohen banesat! Në Dajt angazhohen 2 helikopterë, situata nën kontroll në Krujë (VIDEO)

15 Gusht, 09:25



Zjarret në Dibër, Manja apel prokurorëve: Gjeni zjarrvënësit! Nëse zvarriten hetimet, do i drejtohem i ILD-së për të verifikuar veprimtarinë tuaj! (VIDEO)

14 Gusht, 22:27



Zjarri në parkun e Lurës në Dibër jashtë kontrollit, flakët djegin 300 hektarë pyje! Në operacion 2 avionë dhe 2 helikopterë

14 Gusht, 16:48




Lura në flakë, eksperti ngre dyshime: Çfarë tregon shpërndarja e vatrave? A mund të jetë e qëllimshme?

14 Gusht, 16:14



Kurora e gjelbër e Lurës mbulohet nga tymi, zjarri u afrohet 2 banesave, forcat në terren punojnë pa ndërprerje (FOTO)

14 Gusht, 14:19



Zjarret në Lurë të Dibrës, nis hetimi për shëfën e monitorimit të Parkut Kombëtar dhe dy roje (VIDEO)

14 Gusht, 10:37



U zunë për pronën dhe kërcënoi vëllanë me pistoletë, arrestohet 47-vjeçari në Vlorë (EMRI+VIDEO)

14 Gusht, 09:12



Zjarret/ Lura në flakë, digjen 300 hektarë pyje! Riaktivizohet vatra në Zidoll të Krujës, zjarrfikësit në terren për normalizimin e situatës

14 Gusht, 09:04



Zjarret në vend, Ministria e Mbrojtjes: 14 vatra aktive, 309 efektivë të Forcave të Armatosura në terren! Situata më kritike në Gurë-Lurë të Dibrës

13 Gusht, 21:03



14 vatra zjarri aktive në Shqipëri, Ministria e Mbrojtjes: Situatë e rënduar në Gurë-Lurë të Dibrës dhe Elbasan! Flakët në ‘kurorën’ e Tiranës vihen nën kontroll

13 Gusht, 18:44



Me pistoletë në çantë, arrestohet 21-vjeçari në Elbasan

13 Gusht, 13:58

Lajmi i fundit



Koreja e Jugut propozon bisedime për t'i dhënë fund zrytarisht luftës me Korenë e Veriut

15 Gusht, 22:44





RAPORTO! Chat live
me Shqiptarja.com

